

**TË DREJTAT  
E TË HUAJVE**

**PËRBALLË  
POLICISË**

# TEKSTI HYRËS

Kriza sociale dhe pyetja e Shtetit social në favor të Shtetit social aktiv dhe të politikave të kursimit shkaktojnë sidomos një prirje të izolimit dhe individualizimin që frenon solidaritetet. Kur këto këtu shfaqen, ato duken të dyshimta dhe në fund të fundit të dënuara. Mbyllja e politikave të migracionit dhe ashpërsia kundër atyre që përpiqen të hapin bordin e solidaritetit, janë shembuj të qartë.

Shteti, edhe ai është në krizë, në humbje të pushtetit, të legjitimitetit dhe të kreditit. Çdo gjë shkon sikur ai shpërblen paaftësinë e tij në lidhje me planifikimin social, ekonomik ose internacional, me fjalime të ashpra dhe qëndrime represive, mbi investimi i funksioneve të rregullores të lidhura me kontrollin e popullatave dhe të territorit, domethënë të funksionit të tij policor. Një fonction i përkrahur nga një fjalim dhe një ngulmim për sigurinë që nënkupton çështjet e sigurisë – fizike dhe jo sociale – si shqetësime kryesore të popullatës dhe të politikës.

Ky konjekst pak i gëzueshëm favorizon një pasiguri edhe më të madhe për personat e huaj që qëndrojnë në territorin belg, aq më tepër kur ata nuk kanë leje qëndrimi.

Puna e terrenit të **Picardie Laik të Krahinës** të CAL është sidomos t'ju sjellë popullatave migrante të pranishme në territorin e saj të kompetencës një informacion të saktë në lidhje me të drejtat e tyre, duke respektuar plotësisht dinjitetin e tyre njerëzor dhe duke iu garantuar konfidencialitetin total të situatës tyre administrative.

Në qoftëse **manuali i Mathieu Beys** është një mjet i çmuar për punonjësit e terrenit dhe për qytetarët që përkrahin dhe që shoqërojnë çdo ditë këta persona, ai është edhe më shumë për ata që kanë nevojë, vetë personat e huaj.



Nëpërmjet sintezës, përkthimit dhe shpërndarjes të kapitujve të këtij manuali të konsakruar të drejtave të huajve, **Picardie Laik i Krahinës** synon të kontribuojë në aplikimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të të gjitha qënieve njerëzore dhe të japë përkrahjen e saj personave ndër më të ekspozura të shoqërisë tonë.

Për t'ia arritur, seanca pune dhe shkëmbimesh janë të organizuara me grupe personash me qëndrim të pasigurtë, që ata të informohen më mirë në aspektin e të drejtave themelore.

Kjo punë ka një dimension politik: me këtë veprim, **Picardie Laik i Krahinës** synon të shprehë mospajtimin e saj të plotë me përgjigjen e dhënë kryesisht për sigurinë që iu është kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me azilin dhe me migrantët.

# PËRMBLEDHJE

1. TE HUAJT DHE POLICIA	5
2. KONTROLLET NE KUFI	9
3. HETIME PËRSA I PËRKET MARTESAVE TË RREME	15
4. ARRESTIMET DHE MBYLLJA ADMINISTRATIVE E ATYRE QE JANE « PA DOKUMENTA »	21
5. PËRDORIMI I FORCËS NË RASTIN E LARGIMIT ME DETYRIM NGA VENDI	31
6. PA DOKUMENTA DHE VIKTIMA TE SHKELJEVE	39
7. TË REAGOJMË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TË HUAJVE	41

TË DREJTAT  
E TË HUAJVE  
PËRBALLË  
POLICISË

# 1. TE HUAJT DHE POLICIA

**PO**, në teori , kam të njëjtat të drejta ndaj policisë si çdo qytetar edhe në qoftë se unë jam i huaj ,ose nëse jam me qëndrim të paligjshëm . « Pa dokumenta » nuk do të thotë pra që nuk kam të drejta. Të gjitha të drejtat themelore të përshkruara zbatohen në përgjithësi edhe ndaj atyre që janë « pa dokumenta » : ndalohen trajtimet poshtëruese dhe mbajtja arbitrare , e drejta e jetës private dhe familjare , etj.

**POR** , në qoftë se nuk e kam të drejtën e qëndrimit në Belgjikë , unë mund të rrezikoj , në çdo takim me një polic , edhe në qoftë se i kontaktoj për të bërë një ankesë , një arrestim , një urdhër për të lëshuar territorin, një mbajtje në një qendër të mbyllur dhe një largim drejt vendit tim të origjinës ( ose një tjetër vend që më pranon).

## A KAM TË NJËJTAT TË DREJTA NDAJ POLICISË NË QOFTË SE UNË JAM I HUAJ OSE PA DOKUMENTA ?

## A MUND TË JEM SHKELËS I LIGJIT VETËM SEPSE JAM « PA DOKUMENTA » ?

**PO**, në teori, unë rrezikoj një dënim prej tetë ditësh deri në tre muaj burg, një gjobë dhe një dosje gjyqësore vetëm sepse jam me qëndrim të paligjshëm në Belgjikë ( domethënë në qoftë se unë qëndroj dhe nuk kam të drejtë , por nuk mund të quhem i paligjshëm në qoftë se nuk kam me vete lejen e qëndrimit ose ajo ka skaduar ose jam në pritje të rinovimit të dokumentave).

**POR** , në praktikë , rrallë herë mund të dënohem vetëm për qëndrimin tim të paligjshëm. Shteti nuk ka të drejtë të më dënojë ose të më dërgojë në burg për qëndrim të paligjshëm në qoftë se nuk më ka propozuar më parë kthimin vullnetar ose në qoftë se nuk ka përdorur metoda të tjera ( si psh. vendosje në qendër të mbyllur) për të bërë që unë të largohem, po të jetë nevoja edhe me forcë.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

# 2. KONTROLLET NE KUFİ

## NË CILIN KUFÏ MUND TË MË KONTROLLOJNË ?

Policët mund të më kontrollojnë , pa qënë të detyruar tëjustifikohen , në qoftë se unë kaloj një kufi jashtë hapësirës Shengen . Ekzistojnë trembëdhjetë pika kalimi në kufijtë e jashtëm në Belgjikë : gjashtë aeroporte (Bruksel Nacional, Deurne, Ostende, Gosselies, Bierset , Wevelgem ), gjashtë porte, (Anvers, Gand , Nieuport, Blankenberge, Ostende , Zeebrugge ) dhe terminali Eurostar i stacionit të trenit Bruksel-Midi.

Në përgjithësi ( dhe vetëm për ndonjë përjashtim) , policët nuk mund të bëjnë një kontroll sistematik në qoftë se unë kaloj një kufi të brendshëm (një kufi tokësor me Francën, Gjermaninë , Luksemburgun , Hollandën) ose në qoftë se dal nga një tren ose nga një avion që vjen nga hapësira Shengen.

**POR** , kontrollet në kufijtë e brendshëm mund tëribëhen vetëm në rast të një « kërcënimi serioz për rendin publik ose për sigurimin e brendshëm », për një kohëzgjatje maksimale prej tridhjetë ditësh ose më shumë, vetëm në qoftë se « zgjatja e parashikimit të kërcënimit serioz » është më e madhe se tridhjetë ditë . →

Shteti mund ta rinovojë këtë zgjatje në qoftë se kërcënimi zgjat dhe duhet të informojë publikun lidhur me vendimin që ka marrë për të ushtruar kontroll, vetëm nëse ka arsye të forta sigurie që ta kundërshtojnë ». Belgjika e ka bërë më përpara këtë tip kontrolli sidomos gjatë kampionatit të futbollit Evropian të vitit 2000 për të vëzhguar tifozat.

Ndryshe, policia mundet gjithmonë të më kontrollojë në befasi brenda territorit në zonat kufitare (në qoftë se nuk është një kontroll sistematik i fshehur në kufij ), ose në ndonjë port ose aeroport , për shembull sepse ajo më quan si të dyshimtë ose sepse ka marrë urdhërin për arsye të sigurimit publik ose për kontrollimin e të huajve.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Varet në qoftë se unë kam shtetësinë e njëres prej 28 shteteve të UE ose në qoftë se jam pjesëtar i familjes së një qytetari të UE ( bashkëshorti ose partneri i regjistruar, fëmijë nën moshën 21 vjeç ose në ngarkim të qytetarit të UE ose të bashkëshortit ose partnerit ) ose jo.

### **Në qoftë se unë jam qytetar i UE ose pjesëtar i familjes së një qytetari i UE ( pa marrë parasysh shtetësinë)**

policia mund të bëjë vetëm një « verifikim minimal » domethënë një pamje të thjeshtë dhe të shpejtë të vlefshmërisë së dokumentit « që më lejon të kaloj kufirin. Policia mund të sigurohet që unë jam i njëjti person me atë që është përmendur në dokument dhe që ky dokument nuk është i rremë. Policia mund gjithashtu të konsultojë bazën e të dhënave kombëtare, si BNG (banka e të dhënave të përgjithshme kombëtare) dhe evropiane si SIS (sistemi i informacionit Shengen) për të verifikuar nëse jam vërtetë një kërcënim , aktual dhe mjaft i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm, rendin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare » por ky veprim nuk mund të bëhet rregullisht.

**Në qoftë se unë nuk jam qytetar i UE ose pjesëtar i familjes,** policët mund të bëjnë « një verifikim të hollësishëm » si në hyrje ashtu edhe në dalje te hapësirës Shengen. →

## **ÇFARË MUND TË KONTROLLOJË POLICIA GJATË KALIMIT NË KUFİ ?**

Ata duhet të verifikojnë gjithashtu :

- që nuk e kam shkelur « kohëzgjatjen e qëndrimit maksimal të lejuar » ,
- nga unë kam hyrë e kam dalë nga hapësira Shengen (vulat në pasaportën time ) ,
- provat e qëllimit të qëndrimit tim (letra e ftesës për vizitë familjare ose turistike , provat e veprimtarisë sime të biznesit . . . ) ;
- nëse mjete im i transportit , objektet që unë transportoj ose unë personalisht « nuk paraqesin rrezik për rendin publik , sigurimin e brendshëm, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të njëres prej shteteve anëtare » , duke konsultuar bazën e të dhënave të Sistemit të informacionit Shengen (SIS) « «nëse është e nevojshme ».

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

## A MUND TË MË MARRIN SHENJAT E GISHTAVE GJATË KONTROLLIT NË KUFIT ?

**PO**, në qoftë se unë kërkoj azil ose në qoftë se kam një vizë Shengen për një qëndrim të shkurtër , policët mund të verifikojnë nëse shenjat e gishtave të mia përputhen me ato të personit që ka marrë vizën. Këto shenja janë marrë në ambasadë dhe gjenden në sistemin e informacionit për vizat, « VIS » ( sistemi i informacionit për vizat )

TË DREJTAT  
E TË HUAJVE  
PËRBALLË  
**POLICISË**

# 3. HETIME PËRSA I PËRKET MARTESAVE TË RREME



Policët mund të bëjnë një hetim në qoftë se ata dyshojnë që « qëllimi i njërit prej bashkëshortëve (të ardhshëm) (ose ata që jetojnë së bashku në mënyrë ligjshme) nuk duket se është krijimi i një bashkësie jetese të qëndrueshme , por vetëm përfitimi i lidhur me të drejtën e qëndrimit ». Këtë e quajmë një martesë « të rreme », e « simuluar » ose për interes ».

Hetimi mund të shërbejë për :

- të më dënuar nga një muaj deri në tre vjet burg dhe një gjobë ;
- të kundërshtuar projektin e martesës ose bashkëjetesën ligjore ;
- të bërë të pavlefshme më vonë një martesë ose një bashkëjetesë ligjore.

Në praktikë, policët mbledhin informacionet veçanërisht pranë komshinjeve, pronarit , portierit të ndërtesës, postierit, tregëtarëve, komunës, familjes sime ( për shembull ish bashkëshort-i (ja) fëmijët e mi , dëshmitarët e martesës sime ...)

## NË CILIN RAST MUND TË BËHET NJË HETIM PËRSA I PËRKET MARRËDHËNIES TIME BASHKËSHORTORE ?

## ÇFARË NDOH GJATË MARRJES NË PYETJE NGA ANA E POLICËVE NË QOFTË SE UNË JAM I DYSHUAR PËR MARTESË TË RREME ?

Policët vijnë shpesh në shtëpi për të verifikuar kushtet e jetesës dhe vërtetësinë e bashkëjetesës . Unë mund të kundërshtoj që ata të hyjnë dhe ata nuk kanë të drejtë të hyjnë me forcë, por kundërshtimi im mund të ketë si pasojë një kundërshtim për të kryer martesën time ose për të lejuar bashkëjetesën ligjore.

Unë jam shkelës i ligjit në qoftë se kam bërë ose tentuar të bëj një martesë ose një bashkëjetesë për interes. Marrja ne pyetje mund të bëhet si në një seancë dëgjimi për një të dyshuar dhe duhet të kem të gjitha të drejtat që lidhen pikërisht me mundësinë që të këshillohen nga një avokat para marrjes në pyetje. →

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Policët mund të më pyesin pikërisht :

- si dhe kur e kam njohur të fejuarin (en) tim (e) ;
- kush na ka prezantuar me njëri- tjetrin ;
- kush janë pjesëtarët e familjes së tij (së saj) dhe çfarë bëjnë ata në jetë ;
- kur dhe si kemi folur për martesë ose bashkëjetesë ligjore për herën e parë ;
- cilat janë gjellet, ngjyra, libri, filmi i tij (saj) të preferuar ;
- nëse është bërë një pagesë për të përfunduar marrëdhënien time;
- në qoftë se ne kemi patur marrëdhënie seksuale, në çfarë ritmi dhe kur herën e fundit ;
- cilat janë të ardhurat e secilit dhe si rregullohemi midis nesh për shpenzimet shtëpiake .

Ata mund të bëjnë të njëjtat pyetje partnerit(es) tim(e). Në qoftë se ka shumë kundërshtime, martesë ose bashkëjetesë mund të kundërshtohet ose anulohet.

Si në çdo marrje në pyetje , është në interesin tim ta nënshkruaj proces -verbalin, vetëm pasi ta kem rilexuar mirë dhe të jem plotësisht dakort me përmbajtjen. Është në interesin tim të kërkoj një kopje të proces-verbalit, por policët mund të presin një muaj para se të ma japin.

## A JAM I DETYRUAR T'U PËRGJIGJEM PYETJEVE TË POLICËVE RRETH MARRËDHËNIES SIME ?

**JO**, nuk jam i detyruar të përgjigjem, sepse përgjigjet e mia mund të kenë si pasojë edhe një dënim nga gjykata.

**POR**, në praktikë, në qoftë se unë kundërshtoj ata mund të mendojnë që marrëdhënia ime është e rreme, gjë që mund të shkaktojë kundërshtimin ose anulimin e martesës ose të bashkëjetesës ligjore.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

**A MUND TË  
PËRFSHIHEM  
NË BANKËN E  
TË DHËNAVE  
KOMBËTARE NË  
QOFTË SE BËHET  
NJË HETIM  
KUNDËR MEJE  
PËRSA I PËRKET  
MARTESËS SË  
RREME ?**

**PO**, policët mund të më fusin në bankën e të dhënave të përgjithshme kombëtare (BNG) në qoftë se një gjyqtar e kërkon atë në kuadrin e një hetimi lidhur me projektin tim të martesës ose të bashkëjetesës ligjore. Shtytja ose kundërshtimi i martesës ose i bashkëjetesës ligjore do të përfshihet në regjistrin e popullatës, pikërisht për të shmangur një përpjekje të re nga ana ime, pranë një komune tjetër mbas kundërshtimit të parë.

**TË DREJTAT  
E TË HUAJVE  
PËRBALLË  
POLICISË**

**4.  
ARRESTIMET  
DHE MBYLLJA  
ADMINISTRATIVE  
E ATYRE QE JANE  
« PA DOKUMENTA »**

## KUR MUND TË MË NDALIN MUA SI I HUAJ ?

Në qoftë se unë jam i huaj, policia mund të më ndalojë :

- në të gjitha rastet që lejojnë arrestimin e një qytetari belg ose të huaj.
- në qoftë se unë nuk kam me vete dokumentin e identitetit ose lejen e qëndrimit në rregull.

## A MUND TË TROKASIN NË DERËN TIME VETËM SEPSE JAM « PA DOKUMENTA »?

Në përgjithësi , JO . Në qoftë se rri në shtëpinë time mbasi kam marrë një urdhër për t'u larguar nga territori , unë duhet të përgatitem për një vizitë të policëve. Në qoftë se ata më gjejnë në shtëpinë time, ata mund të më çojnë në një qendër të mbyllur.

Në qoftë se unë kundërshtoj t'ju hap portën , ata nuk mund të përdorin forcën për të hyrë, vetëm në rast urgjence, ose në qoftë se kanë një vendim nga një gjykatës.

Por, ata mund t'i bëjnë një raport Zyrës së të huajve, e cila mund të shënojë kundërshtimin tim dhe, në qoftë se më ndalin pas kësaj , ata mund ta përdorin atë për dërgimin tim të menjëhershëm në qendër të mbyllur. Mund të ndodh gjithashtu që policët përdorin dredhinë për të hyrë në shtëpinë time , duke thënë , për shembull , që ata vijnë për një rrjedhje gazi që nuk ekziston. Ky është një veprim i paligjshëm.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

## MUND TË MË THËRRASIN POLICËT DUKE PËRDORUR NJË ARSYE TË RREME NË KOMISARIAT PËR TË LEHTËSUAR LARGIMIN TIM ?

**JO**, meqënëse jam i huaj me qëndrim të paligjshëm dhe nuk jam i kërkuar për një krim të rëndësishëm , është e ndaluar të më bëjnë një kurth duke treguar një arsye të rreme dhe të pa rëndësishme ( për shembull, « plotësimin e dosjes suaj » që të më tërheqin në komisariat dhe pastaj të më ndalin , të më mbyllin , të më largojnë drejt vendit tim të origjinës (ose një tjetër shtet tjetër që më pranon). Është e ndaluar që « në mënyrë të vetëdijshme të mashtrohen njerëzit, edhe kur janë të paligjshëm, duke i thirrur, për t'i privuar nga liria e tyre.

## POLICIA MUND T'I MARRË FËMIJËT E MI NGA SHKOLLA ?

**PO**, asgjë nuk e ndalon policinë që të ndalojë fëmijët e mi në shkollë për qëndrim të paligjshëm .

Policët duhet të :

- lajmërojnë drejtorinë e shkollës para se të ndërhyjnë dhe të kërkojnë ndihmën e saj në përmbushjen e misionit « me qëllim që të sigurojnë një shoqërim sa më të mirë për fëmijën » ;
- të mos jenë të veshur me uniformë dhe të paraqesin kartën e tyre ;
- mos të ndërhyjnë gjatë orëve të mësimi ;
- në qoftë se është e mundur të shoqërohen nga një tjetër pjesëtar i familjes.

Policët nuk mund të hyjnë brenda në shkollë pa patur lejen e drejtorisë.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Në qoftë se policët më ndalin sepse nuk i kam dokumentat në rregull, ata mund të më mbajnë, vetëm për kohën e nevojshme që ju duhet për të dërguar një raport në Zyrën e të huajve dhe për të pritur vendimin e saj. Policët duhet të më lirojnë sapo të informohen që kam të drejtë të jem në Belgjikë ose që Zyra e të huajve nuk dëshiron të më mbyllin. Mbjajtja ime në polici mund të zgjasë maksimum 24 orë, domethënë dy herë më shumë se një arrest administrativ për Belgët. Në qoftë se Zyra e të huajve nuk merr asnjë vendim brenda këtij afati, ata duhet të më lirojnë. Është në interesin tim të mos nënshkruaj në regjistrin e privimit të lirisë i cili përmban orët e paraburgimit që nuk përputhen me realitetin.

Në bazë të vendimit të Zyrës së të huajve, policët mund :

- të më lënë të lirë pa më dhënë urdhrin që të largohem nga territori, për shembull një procedurë e azilit ose rregullimi është në vazhdim e sipër;
- të më japin një urdhër për të lëshuar territorin në një afat të përcaktuar (maksimum tridhjetë ditë) dhe të më lirojnë;
- të më shoqërojnë drejt një qendre të mbyllur me një urdhër që të largohem nga territori ose të më dorëzojnë tek « bashkëpunëtorët e sigurimit —shoferat » e Zyrës së të huajve ;
- të më shoqërojnë në aeroport me një urdhër që të largohem nga territori.

## **PËR SA KOHË MUND TË MË NDALONË NË QOFTË SE NUK I KAM DOKUMENTAT E MIA NË RREGULL ?**

## **CFARË KAM TË DREJTË TE DI GJATË ARRESTIMIT TIM ?**

Unë kam të drejtë të njoh arsyet e arrestimit tim në një afat të shkurtër dhe në gjuhën që unë kuptoj. Në praktikë, kjo e drejtë respektohet rallë herë sepse për policët mjafton që unë të nënshkruaj marrjen e vendimit të OE për mbylljen time, i cili është i shkruar në frëngjisht ose në flamisht. Si rregull, unë duhet të marr më shumë informacione sapo të arrij në qendrën e mbyllur por ka pak mundësi që të kem një përkthyes. Për të shmangur çdo keqkuptim, është në interesin tim që të mos nënshkruaj asnjë dokument. Fakti që unë kundërshtoj të nënshkruaj një vendim nuk më pengon të kem një kopje.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Si i huaj i ndalur për verifikimin e situatës sime ose në pritje të një urdhri për largimin nga territori, kam të njëjtat të drejta si çdo njeri tjetër i arrestuar. Unë mundem pikërisht :

- të lajmëroj një njeri të besueshëm për arrestimin tim
- të kem një vizitë mjekësore falas
- të pi, të ha në orët normale të ngrënies dhe të kryej nevojat për higjenë.

Parimisht , nuk kam të drejtë të përfitoj ndihmën e një avokati por asgjë nuk më pengon ta bëj kërkesën.

Para largimit tim me forcë,unë kam të drejtë të bëj valixhet dhe të marr një inventar të policisë ku përshkruhen objektet që kam marrë dhe ato që kam lënë në Belgjikë dhe informacionet mbi masat që janë marrë në mënyrë që unë t'i tërheq ato më vonë.

## CILAT JANË TË DREJTAT E MIA GJATË ARRESTIMIT NË KOMISARIATIN E POLICISË ?

## A JAM I DETYRUAR T'I PËRGJIGJEM PYETJEVE TË POLICËVE ?

**JO**, kam të drejtë të mos flas si për çdo marrje tjetër në pyetje .

Në qoftë se unë nuk kam dokument identiteti , Zyra e të huajve duhet të jetë në dijeni nga vij unë dhe të merret vesh me vendin tim të origjinës para se të më largojnë nga vendi. Policët pra, do të më bëjnë pyetje për të ditur kush jam dhe nga cili vend vij .

Ata mund të kërkojnë një përkthyes për të mësuar origjinën time në bazë të gjuhës që flas dhe theksit tim ( mund të ndodh , për shembull , që të huajt që e paraqesin veten si palestinezë janë të konsideruar si marokenë , tunizianë ose algjerianë).

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

## A MUND TË MË LARGOJNË ME FORCË NGA VENDI SEPSE JAM STREHUAR PA LEJEN E PRONARIT NË NJË NDËRTESE?

**JO**, thjesht fakti që strehohem në një ndërtesë pa lejen e pronarit nuk është krim . Në qoftë se dokumentat e mia janë në rregull ( viza ose dokument qëndrimi i vlefshëm ) , dhe që sjellja ime nuk përbën asnjë problem për rendin publik , autoritetet nuk mund të më përzhënë nga vendi vetëm sepse kam zënë qetësisht një ndërtesë.

Në rast të kundërt, në qoftë se unë kundërshtoj të jap kartën time të identitetit, policia mund të më konsiderojë si një i huaj me qëndrim të paligjshëm dhe mund të më vendosë në një qendër të mbyllur sepse sipas ligjit, një i huaj është « ai (ajo) që nuk jep provën e shtetësisë belge ».Në qoftë se policia më quan si të huaj kur nuk ka arsye të dyshojë për shtetësinë time belge , duhet konsideruar që ajo shpërdoron procedurën.

TË DREJTAT  
E TË HUAJVE  
PËRBALLË  
POLICISË

# 5. PËRDORIMI I FORCËS NË RASTIN E LARGIMIT ME DETYRIM NGA VENDI



Policia mund të përdorë forcën në qoftë se « e kundërshtoj largimin tim » ose kur unë « paraqes një rrezik gjatë largimit tim » por duhet gjithmonë të respektoj rregullat e përgjithshme të përdorimit të forcës ( domethënë : të përdoret forca vetëm nëse është shumë e nevojshme për të arritur synimin e ligjshëm duke marrë parasysh rreziqet dhe duke përdorur një forcë proporcionale.

Në një qendër të mbyllur, duhet të më tregojnë një DVD që shpjegon etapat e ndryshme të procedurës së largimit tim të detyruar nga vendi , shtjellimi i së cilës shpjegohet më poshtë në mënyrë graduale.

**1.** Në fakt , duhet të më jepet mundësia të marr avionin pa praninë e policëve në mënyrë që të hyj pa tërhequr vëmendjen. Në këtë rast, mund të marr një « shpërblim për largimin » deri në 100 euro në qoftë se unë e kërkoj.

**2.** Në qoftë se unë kundërshtoj të iki lirisht, policët do të vijnë të më marrin. Ata do të më shoqërojnë deri tek avioni dhe do të kërkojnë që unë të nisem. Në qoftë se unë kundërshtoj pa dhunë, ata duhet të më kthejnë në qendër të mbyllur pa më detyruar që të nisem .

**3.** Në rast të kundërt , policët vijnë përsëri të më marrin dhe mund të më detyrojnë të hipi në avion dhe të udhëtoj deri në vendin tim të origjinës ( ose një vend tjetër që më pranon ). →

## NË CILAT RASTE POLICIA MUND TË PËRDORË FORCËN KUNDËR MEJE PËR TË MË LARGUAR ME DETYRIM NGA VENDI ?

**4.** Në qoftë se kjo etapë dështon sepse unë rezistoj , policët mund ta provojnë përsëri të më hipin me forcë në një fluturim tjetër të planifikuar. Në disa raste, unë mund të kthehem në vendin tim me një avion tjetër të sigurt, i marrë me qira për rastin, i organizuar në bashkëpunim me shtetet e tjera të UE. Një mjek dhe një kontrollues i inspektimit të përgjithëm të policisë do të jenë të pranishëm, si dhe një përkthyes për të më lejuar të flas me mjekun në gjuhën time.

Por kjo skemë nuk bëhet gjithmonë dhe nuk është e detyrueshme. Nëse Zyra e të huajve ka arsye të forta të mendojë që nuk ia vlen të tentojmë etapat 1,dhe 2 , për shembull sepse unë jam agresiv , dhe që kam thënë gjithmonë që nuk dua të kthehem në vendin tim ose ka patur tentativa të dëbimit gjatë një arrestimi të mëparshëm, policët do të përdorin forcën dhe do të më përcjellin deri tek avioni duke zbatuar direkt etapën 3.

Edhe në etapën 3 ose 4, policët nuk mund të « prekin dinjitetin tim dhe as integritetin tim fizik » dhe, në rast dyshimi , ata duhet të ndërpresin dëbimin dhe përdorimin e forcës, edhe nëse rezistoj , për të respektuar parimin « jo largimin me çdo kusht ».

Policët dhe punonjësit e Zyrës së të huajve mund të më kontrollojnë para çdo tentative dëbimi për të parë nëse mund të kem ndonjë gjë të rrezikshme.

Në qoftë se kam para ose objekte me vlerë, ato duhet të futen në një zarf në emrin tim dhe policët duhet të më informojnë lidhur me këtë veprim. Unë duhet t'i tërheq ato kur të mbërrij. →

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

## ÇFARË MËNYRASH MUND TË PËRDORË POLICIA PËR TË MË DËBUAR NGA VENDI?

Gjatë rrugës për në qendrën e mbyllur ose duke u larguar nga ajo, « bashkëpunëtorët e sigurimit –shoferët » e Zyrës së të huajve mund të përdorin forcën ( përdredhje të krahut, prangat ose « forcën fizike »).

- për të më mbajtur nën kontroll, nëse sjellja ime përbën një rrezik për integritetin tim fizik ose për atë të personave të tjerë , ose nëse prish rendin ;
- për të kryer një transferim sa më të mirë , nëse ata kanë « arsye bindëse të besojnë » (sipas sjelljes time , indekseve materiale ose të rrethanave ) që unë përbëj një rrezik për integritetin tim fizik ose për atë të personave të tjerë , ose që unë « do të prish qetësinë ».

Në qoftë se ata përdorin forcën, policët duhet të marrin gjithmonë parasysh shëndetin tim, sigurinë time edhe atë të pasagjerëve të tjerë. Në bazë të sjelljes sime, me urdhrin e komandantit, ata mund të përdorin pikërisht :

- prangat, por në mënyrë « krejt të veçantë” dhe nuk mund të më lidhin kurrë në një pikë fikse të avionit;
- rripat e sigurimit (që lirohen shpejt) ;
- rripat prej najloni;
- ngjitësat për të lidhur këmbët dhe gjunjët;
- kokoret e boksit (vetëm për fluturimet e siguruara).

Por, ata nuk mund të përdorin mjete të rrezikshme ose dëmtuese si për shembull

- armë;
- objekte që bllokojnë ose që pengojnë frymëmarrjen time (jastëkë, mbyllje të gojës . . .)
- ilaçet pikërisht ato anestezike ose të qetësimit;
- teknikat për t'u përkulur më dysh ose të më ngjeshin kafazin e kraharorit;
- të më vënë pelena. ➔

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

## A MUND TË SHOH NJË MJEK ?

Të paktën 40 minuta para nisjes, policët duhet të lajmërojnë komandantin për largimin tim të detyruar dhe të marrin masat e parashikuara të sigurisë. Piloti mund të kundërshtojë gjithmonë që unë të hipi në avion, në qoftë se ai mendon që siguria e fluturimit nuk është e garantuar. Ata që nuk u binden udhëzimeve të komandantit duke përfshirë këtu edhe policët, bëhen keqbërës.

Gjatë fluturimit, unë jam keqbërës në qoftë se, për shembull :

- unë shkatërroj ose dëmtoj me dashje pajisjet në avion siç janë: (ndenjëset e avionit, tavolinat e vogla. . .) ;
- nuk u bindem udhëzimeve të komandantit lidhur me sigurinë ose rregullin në avion dhe të pasagjerëve ;
- nëse kërcënoj ekipin e punonjësve të avionit ose pasagjerët.

Kur të mbërrij , policët duhet të më heqin prangat ose lloje të tjera pengesash para se të më dorëzojnë tek autoritetet e vendit të destinacionit.

**PO**, unë duhet të shoh një mjek para dhe pas çdo përpjekje të largimit me detyrim që nuk është bërë, nëse më bie të fikët gjatë transferimit midis qendrës së mbyllur dhe aeroportit. Unë kam të drejtën të konsultoj falas mjekun e qendrës së mbyllur jo më vonë se 48 orë mbas kthimit tim në aeroport dhe mjeku duhet të bëjë një raport. Ky mjek ka për qëllim të « mbajë pavarësinë profesionale ndaj drejtorit të qendrës » dhe « vlerësimet dhe vendimet e tij » lidhur me shëndetin tim duhet të jenë « të bazuara mbi kriteret mjekësore ». Nëse mund ta paguaj , kam të drejtën të sjell mjekun që kam zgjedhur unë.

Në qoftë se unë jam i larguar me tre të huaj të tjerë ose më tepër , një mjek dhe një vëzhgues i pavarur duhet të na shoqërojnë në avion.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

# 6. PA DOKUMENTA DHE VIKTIMA TE SHKELJEVE

## A MUND TË BËJ ANKESË NË POLICI NË QOFTË SE UNË JAM « PA DOKU- MENTA » ?

**PO, POR** është në interesin tim të jem shumë i kujdesshëm dhe të konsultoj një avokat para çdo përpjekjeje në qoftëse unë nuk jam në një situatë rreziku të menjëhershëm.

Në qoftë se unë jam viktimë e një shkeljeje, kam të drejtë, si çdo qytetar, të bëj ankesë, edhe në qoftë se jam me qëndrim të paligjshëm. Policët duhet të më ndihmojnë si për çdo viktimë tjetër dhe nuk mund të kundërshtojnë ndihmën ose të marrin ankesën time me preteksin që qëndrimi im nuk është në rregull. Por, në qoftë se unë jam me qëndrim të paligjshëm, polici mund të më konsiderojë si një që njeri keqbërës dhe të më denoncojë tek prokurori. Ai duhet gjithashtu të më ndalojë mua dhe t'u bindet udhëzimeve të Zyrës së të huajve e cila mund të lëshojë një urdhër për t'u larguar nga territori dhe ndoshta vendosjen time në një qendër të mbyllur.

Polici pra duhet të më ndihmojë si viktimë dhe, në të njëjtën kohë, të më denoncojë si një njeri « pa dokumenta ».

Në praktikë, unë rrezikoj që të më ndalin në qoftë se unë shkoj spontanisht të bëj ankesë në komisarariat, edhe për fakte serioze, siç është një përdhunim. Eshhtë e pamundur për të vlerësuar mirë këtë rrezik sepse ai varet nga faktorë që unë nuk mund t'i zotëroj dot, p.sh. (ndjeshmëria e policit dhe e hierarkisë së tij, sjellja e prokurorit dhe e Zyrës së të huajve, vendet e disponueshme në qendër të mbyllur. . . .) .Në qoftë se nuk jam në rrezik të menjëhershëm, është në interesin tim të konsultohem në fillim me një avokat.

TË DREJTAT  
E TË HUAJVE  
PËRBALLË  
POLICISË

# 7. TË REAGOJMË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TË HUAJVE

Në qoftë se kam një të afërm me qëndrim të paligjshëm të ndalur, unë mund të kontaktoj:

- Zyrën e të huajve dhe qendrën e mbyllur për t'i informuar nëse një datë e riatdhësimit është parashikuar ;
- një avokat për të bërë një ankesë kundër urdhrit për largimin nga territori dhe një ankesë tjetër lidhur me vendimin e paraburgimit dhe dhe t'i japë atij të gjitha informacionet dhe dokumentat e nevojshme (provat e e lidhjeve të ngushta të të huajit në Belgjikë, dokumentat e procedurës dhe të identitetit...);
- një grup militant, një ONG (organizatë jo qeveritare) ose Qendra për barazinë njerëzore, që vizitojnë qendrat e mbyllura dhe që mund nganjëherë të përkrahin atë që është i mbyllur.

## ÇFARË DUHET TË BËJ NË QOFTË SE KAM NJË TË AFËRM TË VENDOSUR NË NJË QENDËR TË MBYLLUR ?

## SI MUND TË SHKOJ PËR VIZITË TEK NJË I AFËRM I BURGOSUR NË NJË QENDËR TË MBYLLUR ?

Unë mund të shkoj t'i bëj vizitë atij me kusht që të kem një dokument identiteti dhe të jap provën që ka lidhje të afërt (bashkëshort, partner, prind, fëmijë, vëlla, motër, xhaxha, teze). Mund të ketë ndonjë përjashtim i pranuar nga drejtori i qendrës. Në qoftë se jam i martuar ose bashkëbanues ligjor ose jap provën që kam lidhje të qëndrueshme prej gjashtë muajsh me të burgosurin, unë mund të kem të drejtën e një vizite intime prej dy orësh çdo muaj mbas një muaji burgosjeje. Mund të më kundërshtojnë autorizimin vetëm në qoftë se i huaji nuk dëshiron të më takojë, në qoftë se nuk mund të jap provën e një « interesi të ligjshëm », nëse vizita ime « përbën një rrezik për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, rendin publik dhe të funksionimit të mirë të qendrës » ose në qoftë se « integriteti moral ose fizik i të burgosurit është në rrezik. Unë mund t'i sjell ushqime dhe objekte që nuk janë të ndaluara nga rregullorja e brendshme (por, jo alkool ose objekte që mund të konsiderohen si të rrezikshme).

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Në qoftë se jam i burgosur, është në interesin tim:

- të kërkoj të kontaktoj me familjen time dhe me një avokat sa më shpejt që të jetë e mundur;
- të kërkoj një kopje për të gjitha pjesët e dosjes dhe t'ia dërgoj avokatit tim që ta shqyrtojë dosjen time dhe të bëjë një ankesat e nevojshme ;
- të mos nënshkruaj asgjë pa qenë i sigurt për përmbajtjen sepse mund të më kërkojnë që të nënshkruaj një dokument në të cilin unë pranoj largimin me detyrim ose të braktis një procedurë azili ose ankesë që është bërë nga avokati i im.

### **Çfarë të bëj në qoftë se jam viktimë e dhunës gjatë tentativës së largimit me detyrim?**

Këshillat e dhëna në rast dhune kundër çdo personi janë të vlefshme edhe për të huajt e përzënë.

Para kohe, unë mund të lajmëroj Inspektimin e përgjithshëm të policisë lokale ose Komitetin P (Komitetin e përhershëm të kontrollit të shërbimeve të policisë ) me faks, që kam frikëpër përdorimin e dhunës lidhur me largimin me detyrim, të parashikuar mbas disa ditësh ose ta pyes avokatin tim që ta bëjë. Unë mund të kërkoj një vëzhgues të panjohur për të parë sjelljen e policëve lidhur me tentativën e ardhshme të largimit me forcë. →

## **ÇFARË MUND TË BËJ NË QOFTË SE JAM I BURGOSUR NË QENDËR TË MBYLLUR ?**

Në qoftë se jam viktimë e dhunës abuzive gjatë një tentative të largimit me detyrim, unë mundem gjithashtu ;

- t'i kërkoj Zyrës së të huajve, policisë ose inspektimit të përgjithshëm një kopje të raportit të policisë para tentativës së largimit të detyruar që përmban identitetin e policëve të implikuar ose raportin e shkruar nga Inspektimi i përgjithshëm nëse kontrolluesit kanë qenë të pranishëm ose të raportit të përgjegjësve të transferimit nëse incidenti ka ndodhur gjatë një transferimi ;
- të dërgoj shpejt një faks në qendër të mbyllur për të kërkuar një kontroll mjekësor të shpejtë dhe një kopje të raportit të plotë të cilin doktori e ka me të detyruar që ta bëjë mbas çdo tentative të largimit me detyrim dhe raportin që punonjësi social ose psikologu duhet të bëjë në qoftë se ankohe për trajtim të ashpër ;
- nëse është e nevojshme, të kërkoj me ngulm një mjek të besueshëm, që duhet ta paguaj unë, të vijë të më kontrollojë dhe të bëjë një raport të plotë ;
- të bëjë një ankesë pranë Komitetit P, nëse është e nevojshme pranë Inspektimit të përgjithshëm ose të kontrollit të brendshëm.

Eshtë në interesin tim që të konsultoj një avokat sa më shpejt që të jetë e mundur, në bazë të rrethanave pikërisht :

- të më ndihmojë lidhur me disa përpjekje të përshkruara si më sipër ;
- të bëjë një ankesë penale dhe t'i kërkojë prokurorit pezullimin e largimit tim me detyrim deri sa të jetë e nevojshme për hetimin.
- të bëjë një procedurë civile kundër autoriteteve publike në qoftë se kam pësuar dëmtime për shkak të veprimtarive të paligjshme lidhur me tentativën e largimit tim me detyrim ose të largimit tim efektiv nga territori.

■ *Tiré du manuel de Mathieu Beys*

Këto skeda janë të shkruara sipas librit të mëposhtëm që përmban referencat e bazave ligjore dhe të jurisprudencës së nevojshme :



**Mathieu BEYS,  
Quels droits face  
à la police ?**

Manuel juridique et pratique,  
Bruxelles-Liège,  
Couleur livres  
Jeunesse & droits, 2014,  
596 p, (prix : 24 euros)

**Mathieu BEYS, Cilat janë të  
drejtat lidhur me policinë ?**

Manuali juridik dhe praktik,  
Bruksel dhe Liège,  
Ngjyrë librat – Rinia & të drejtat , 2014,  
596 f, (çmimi :24 euro )

## Remerciements

L'auteur Mathieu BEYS, Maria-Gladys BUSSE et Marichela VARGAS pour la traduction Espagnol, Mira LUSEKI et Justin VITA DIASONAMA pour la traduction en Lingala, le Sétis Wallon et l'équipe du Relais de Mons-Picardie Laïque.





Dans le cadre de la campagne  
d'Education Permanente  
**Contester est un droit**  
du Centre d'Action Laïque



Téléchargeable gratuitement sur [www.picardie-laique.be](http://www.picardie-laique.be)